

VENDIM
Nr. 56, datë 9.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “DRAFTKONTRATËS TIP
PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE QË
REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË
NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETIN E SHPËRNDARJES, PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 23.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, për fillimin e procedurës për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, ka përcjellë në ERE “Draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018 rezulton e panënshkruar nga të dyja palët.

- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017, përcaktohet se kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

- Në datën 7.3.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 1017/3, datë 7.3.2018 dhe nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018 të ERE-s.

- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakordësuar të kësaj kontrate, ka pasur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë e palëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi